Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY

ARRU

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-
REPUBLIC OF KOSOVO
Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
Regulatorni Autoritet za Usluge Vode
Water Services Regulatory Authority
N. prot./Prot. Br./ Prot. No. 415
Njësia/Jedinica/Unit D
Nr. kërkesës/Upis. Br./Req. No.
Data/Datum/Date 30.11.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

PLANI I PERFORMANCËS PËR VITIN

2021

Nëntor, 2020

Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit

Vizioni

"Shërbime cilësore, të sigurta dhe efiçente të shërbimeve të ujit, për të gjithë konsumatorët në Kosovë"

Misioni

"Rregullimi i shërbimeve të ujit në mënyrë efektive dhe transparente në pajtim me praktikat e mira Evropiane, të cilat sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të ujit të japin shërbime kualitative, të qëndrueshme dhe me çmime të përballueshme në tërë Kosovën, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit Publik''

LISTA E SHKURTESAVE

ARRU – Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
BD – Bordi i Drejtorëv të KRU
IKSHPK – Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës
IAWD – Shoqata Ndërkombatare e Ujit të Danubitt
IBNET – Rrjeti Ndërkombëtar i Bechmarkingut
NJPM-NP – Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
NjI – Njësia për inspektim
KNMU – Këshilli Ndërministror për Ujërat
MZHE – Ministria e Zhvillimit Ekonomik
MIE – Ministria e Integrimeve Evropiane
MEF – Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MMPH – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
KRU – Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit
KK – Komisioni Funksional Parlamentar i Kuvendit të Kosovës
KZA – komisioni për zgjidhjen e Ankesave
UPF – Uji i Pa Faturuar
PMA-Plani i menaxhimit të aseteve
D – Drejtori i ARRU
DL&L– Departamenti për ligj dhe licenca
DRP – Departamenti për raportim të performances
DAF – Departamenti për administratë dhe financa
DT – Departamenti për tarifa
DANUBIS – Programi i Bechmarkingut të Vendeve të Regjionit të Danubit
ERRU – Enti Rregullator i Ujit të Shqipërisë
QK – Qeveria e Kosovës
GNI – Grupi Ndëristitucionali themeluar nga KNMU
GIS – Sistemi informativ gjeografik
SCO – Zyra Zvicerane për Zhvillim
SHUKOS – Shoqata e Ujësjellësve dhe Kanalizimeve të Kosovës
SKZH – Strategjia kombëtare për zhvillim
Z.V – Zëvendës Drejtori i ARRU
ZMP – Zyrtar për Marëdhënie me Publikun
WAREG – Shoqata Evropiane e Rregullatorëve të Ujit

PËRMBAJTJA:

1. HYRJE	5
2. ROLI DHE PËRGJEGJËSITË E ARRU	6
3. DEPARTAMENTET E ARRU	7
4. STRUKTURA ORGANIZATIVE (ORGANOGRAMI)	8
5. SYNIMET, OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET	9
6. PLANI DINAMIK I VEPRIMEVE PËR VITIN 2021	17
7. REALIZIMI DHE MONITORIMI I PLANIT	27
8. FINANCIMI I PLANIT-BUXHETIT PËT VITIN 2021	28
9. LISTA DHE MENAXHIMI I RISKUT	29

1. HYRJE

Plani i performancës i paraqitur në këtë dokument është udhërrëfyes për aktivitetet e Autoritetit Rregullator për Shërbime të Ujit në Kosovë (ARRU) për vitin 2021. Në këtë plan janë përcaktuar objektivat dhe aktivitetet specifike të ARRU të cilat janë në përputhje me synimet strategjike të parapara me Planin Strategjik. Ky vit është viti i parë i zbatimit të planit Strategjik 2021 -2023 të ARRU, synimet e të cilit janë:

- Avancimi dhe zbatimi i legjislacionit - Kornizës rregullatore;
- Avancimi dhe zbatimi efektiv i procesit tarifor;
- Përmirësimi i performancës së ofruesve të shërbimeve;
- Avancimi dhe përmirësimi i standardeve të shërbimeve;
- Qëndrueshmëria operative dhe financiare e ARRU;
- Ngritja e profilit të ARRU.

Me qëllim të përmbushjes së këtyre synimeve, ARRU i ka përcaktuar dhe zbërthyer objektivat dhe aktivitetet të cilat për vitin 2021 janë specifikuar në këtë plan të performancës, i cili njëkohësisht paraqet bazën për planifikimin e punës së personelit të ARRU, përcaktimin e detyrave dhe afatet kohore për përmbushjen e këtyre detyrave gjatë vitit 2021.

Kostoja e parashikuar e realizimit të planit në vitin 2021 do të realizohet nga buxheti i ARRU-së.

Për realizimin e këtij Plani jemi mbështetur në kapcitetet njerëzore dhe profesionale të të punësuarve të ARRU.

2. ROLI DHE PËRGJEGJËSITË E ARRU

Bazuar në Ligjin për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit - Ligji Nr. 05/L-042 dhe Ligji nr. 06/L -088 për Ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit nr. 05/l-042 për Rregullimin e Shërbimeve të ujit, Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) ka për detyrë rregullimin e veprimtarive të ofruesve të shërbimeve të ujësjellësit, ujërave të ndotura dhe të furnizuesve të ujit me shumicë.

Roli i ARRU është që të sigurojë që ofruesit e shërbimeve ofrojnë shërbime cilësore, efiçente, të sigurta në baza jo-diskriminuese për tërë konsumatorët në Kosovë, duke pasur parasysh mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin e publik.

Përgjegjësitë kryesore të Autoritetetit janë të:

(i) Licencojë ofruesit e shërbimeve dhe mbikëqyr zbatimin e kushteve të përcaktuara me licencë të shërbimit në mënyrë që të mbrojë interesat e konsumatorëve dhe të sigurojë që tregu të zhvillohet në mënyrë të rregullt dhe brenda kuadrit ligjor;

(ii) Përcaktojë tarifat e ofruesit të shërbimeve, duke siguruar që tarifat të jenë të drejta, të arsyeshme dhe të mundësojnë qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve;

(iii) Vendos standardet e shërbimit dhe mbikëqyrë zbatimin e tyre nga ofruesit e shërbimeve të ujit;

(iv) Monitorojë performancën e KRU, duke i nxitur dhe inkurajuar për efikasitet dhe të qëndrueshmëri;

(v) Zgjidhë ankesat e konsumatorëve, për të cilat konsumatori pretendon se ofruesi i shërbimit ka vepruar në kundërshtim me legjislacionin përkatës në fuqi;

(vi) Inspektojë përmbushjen e standardeve të shërbimit dhe zbatimin e akteve ligjore të Autoritetit;

(vii) Hartojë dhe miratojë rregullore dhe vendime rregullatore në pajtim me autorizimet që ka në bazë të këtij ligji dhe ligjeve tjera të aplikueshme.

3. DEPARTAMENTET E ARRU

Me qëllim të operimit më efiçent, ARRU ka aprovuar strukturën organizative të ndarë në katër (4) Derpartamente dhe Njësinë për Inspektim. Tri Departamente dhe Njësia për Inspektim realizojnë aktivitete funksionale, ndërsa Departmenti i Administratës është i angazhuar në mbarëvajtjen e çështjeve të brendshme administrative.

Numri i përgjithshëm i stafit është 21 të punësuar përfshirë menaxhmentin e lartë - Drejtorin dhe Zëvendës Drejtorin e ARRU. Të gjithë të punësuarit kanë profile adekuate profesionale dhe ngritje të lartë akademike.

Departamentet, Njësia për Inspektim i përgjigjen në mënyrë direkte Drejtorit dhe Z.v Drejtorit të ARRU si persona përgjegjës për të marrë vendime rregullatore.

Drejtori dhe Zv. Drejtori i ARRU kanë përgjegjësi ligjore për administrimin dhe menaxhimin e Autoritetit si dhe marrjen e vendimeve për çështjet që u përkasin funksioneve rregullatore të Autoritetit.

Departamenti për çështje ligjore dhe licencim i siguron Autoritetit mbështetjen ligjore. Ky department gjatë përgatitjes së akteve ligjore dhe nën-ligjore bazohet në ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës. Menaxhon procesin e licencimit të ofruesve të shërbimeve të ujit përfshirë edhe vlerësimin në baza të rregullta të përmbushjes së kushteve të licencimit dhe propozimin e masave për përmirësim si dhe zgjedhjen ankesave të Konsumatorëve.


Departamenti për tarifa i siguron Autoritetit mbështetjen në procesin e përcaktimit të tarifave për ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujit. Ky proces përfshin caktimin e caqeve të arritshme dhe sfiduese për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve të ofruara. Përmes këtij procesi departamenti siguron gjetjen e bilancit në mes të mbrojtjes së interesit të konsumatorëve dhe rritjes së qëndrueshmërisë financiare të ofruesve të licencuar të shërbimeve. Ky departament siguron në baza të rregullta vlerësimin e përmbushjes së caqeve dhe propozimin e masave për përmirësim.

Departamenti për raportim të performancës i siguron Autoritetit mbështetjen në aktivitetin e raportimit të përmbushjes së caqeve tarifore. Ky department bën grumbullimin dhe auditimin e saktësisë së të dhënave të raportuara nga ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujit në lidhje me caqet tarifore, përpunimin e këtyre të dhënave në tregues dhe interpretimin e tyre.

Departamenti i administratës dhe financave i siguron Autoritetit mbështetje administrative. Ky department mbështet udhëheqjen e Autoritetit për funksionim, duke menaxhuar me burimet njerëzore, buxhetin dhe financat e Autoritetit, aktivitetet ndihmëse, si dhe koordinimin e furnizimit dhe mirëmbajtjes së pasurisë së Autoritetit.

Njësia për Inspektim i siguron Autoritetit mbështetjen në aktivitetin e inspektimit në përgjithësi dhe në raportimin dhe inspektimin e përmbushjes së standardeve të shërbimeve në veçanti duke përfshirë grumbullimin, inspektimin në vend-ndodhje, përpunimin e të dhënave në tregues, si dhe interpretimin e tyre.

4. STRUKTURA ORGANIZATIVE (ORGANOGRAMI)



5. SYNIMET STRATEGJIKE, OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET

Në vijim janë paraqitur objektivat dhe aktivitetet konkrete të cilat ARRU ka planifikuar të i zhvillojë gjatë vitit 2021, me qëllim të përmbushjes së synimeve strategjike sipas Planit Strategjik 2021-2023 dhe arritjes së synimit të përgjithshëm - përmirësimin e nivelit të shërbimeve të ujit.

Synimi Strategjik 1: Avancimi dhe zbatimi i legjislacionit

Hartimi, fuqizimi dhe zbatimi i kuadrit ligjor dhe rregullator, si dhe legjitimiteti i veprimeve rregullative varet nga kuadri i drejtë ligjor dhe rregullator i cili balancon interesat e konsumatorëve, ofruesve të shërbimeve dhe krijuesve të politikave në këtë sektor. Për të arritur këtë qëllim janë planifikuar objektivat dhe aktivitetet në vijim:

Objektiva 1: Krijimi i mjedisit të favorshëm ligjor, rregullator për përmirësimin e vazhdueshëm në fushën e rregullimit të veprimtarisë së ofrueseve të shërbimeve të ujit

Aktivitetet:

- Angazhimi në Ndryshim plotësimin e Ligjit për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, në rast të inciativës nga Kuvendi apo Qeveria;
- Përafrimi i legjislacionit të ARRU me legjislacionin e Bashkimit Evropian;
- Mbështetje profesionale në hartimin e akteve normative të KRU-ve dhe vlerësimin e ligjshmërisë së tyre;
- Hartimi i shkresave zyrtare, vendimet për ankesat të shqyrtuara dhe shkresa tjera;
- Hartimi i vendimeve, kontratave, marrëveshjeve dhe dokumenteve ligjore që ndikojnë në zbatimin e mandatit ligjor të ARRU-së;
- Përcjellja e proceseve gjyqësore, përgatitja e parashtresave të lëndëve për procedim në Gjykata dhe pjesëmarrja në seancat gjyqësore sipas kërkesës së Gjykatave të Republikës së Kosovës lidhur me të gjitha lëndët që kanë të bëjnë me ARRU-në;
- Rishikimi i infrastrukturës ligjore lidhur me nevojat për ndryshim plotësim të akteve nënligjore të ARRU;
- Përgjigje në ankesat e pranuara nga personat fizik dhe juridik, për çështje të ndryshme.

Synimi Strategjik 2: Avancimi dhe zbatimi efektiv i procesit tarifor

Ndër qëllimet kryesore të rregullimit është sigurimi i efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së ofruesve të shërbimeve në veprimtarinë e tyre, gjithmonë duke pasur parasysh përballueshmërinë e tarifave, si dhe përmirësimin e infrastrukturës me qëllim të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve të cilat u ofrohen konsumatorëve. Duke zbatuar politika të drejta tarifore dhe mbulimit me kosto tarifore të aktiviteteve të tyre, ARRU do të vazhdojë të shtyjë ofruesit e

shërbimeve për t'u bërë kompani financiarisht edhe më të qëndrueshme përmes qeverisjes së mirë të ndërmarjes.

Për shkak të situatës së krijuar si pasojë e COVID-19, ARRU për vitin 2021 ka paraparë proces të përcaktimit të tarifave vetëm për vitin 2021. Gjatë vitit 2021 ARRU do të vazhdojë me procesin tarifor afatmesëm të shërbimeve publike të ujit të periudhës tarifore 3 vjeçare 2022-2024. Rishikimin dhe avancimin e mëtejm të politikave tarifore, modeleve tarifore, si dhe proceseve afat-gjate të planifikimit gjatë shqyrtimit të ardhshëm tarifor trevjeçar 2022-2024, do të vazhdojë të ketë për qëllim qëndrueshmerinë financiare dhe operative të KRU. Avancimi dhe zbatimi efektiv i procesit tarifor planifikohet të arrihet përmes objektivave dhe aktiviteteve në vijim:

Objektiva 1: Shqyrtimi i procesit tarifor aktual

Aktivitetet:

- Përfundimi i raportit mbi vlerësimin e shkallës së përmbushjes së objektivave të KRU-ve gjatë vitit 2020;
- Analiza e Realizimit të Caqeve për vitin 2020;
- Analiza Vjetore e Investimeve Kapitale për vitin fiskal 2020;
- Vizita të rregullta dhe të jashtëzakonshme të KRU-ve për mbledhjen dhe inspektim të të dhënave për vlerësim të punës së tyre gjatë vitit 2021;
- Analiza e shpenzimeve të sektorit për vitin 2020;

Objektiva 2: Procesi tarifor 2022-2024

Aktivitetet:

- Aktivitetet përgaditore për procesin tarifor 2022-2024;
- Mbajtja e takimeve me përfaqësuesit e KRU-ve, për të definuar çështjet tarifore për vitin 2022 si dhe draftimi dhe diskutimi i BPRR;
- Organizimi i dëgjimeve publike;
- Përgatitjet dhe lëshimi i urdhëresave tarifore për tarifat e shërbimeve të ujit 2022-2024 për të gjitha KRU-të;

Objektiva 3: Avancimi i mëtejm i politikave tarifore

Aktivitetet:

- Rishqyrtimi i Politikave Tarifore dhe Udhëzimit të Kontabilitetit Tarifor;
- Analiza periodike për përsosjen e sistemit tarifor;
- Angazhimi për të siguruar donacion për ekspertizë ndërkombëtare të politikave tarifore dhe implementimin e tyre konform rrethanave të ARRU.

Objektiva 4: Azhurnimi dhe publikimi i dokumenteve për procesin tarifor

Aktivitetet:

- Përgatitjet dhe lëshimi i Urdhëresave tarifore për tarifat e shërbimeve të ujit 2022 për të gjitha KRU-të;
- Angazhim rreth implementimit të PMA në KRU-2021;
- Mbledhja, regjistrimi, analiza dhe vlerësimi i të dhënave të realizuar nga KRU-të për përcaktim të tarifave të vitit 2022;
- Përditësimi i Hartave në GIS.

Synimi Strategjik 3: Përmirësimi i përformancës së ofruesve të shërbimeve

Nxitja e konkurrencës përmes monitorimit të vazhdueshëm dhe efektiv, si dhe udhëheqja e një procesi të konsultimit me KRU dhe palët e tjera të interesit me synim përmirësimin e përgjithshëm të performancës, në veçanti të disa prej treguesve kryesorë të cilët do të kenë ndikim të rëndësishëm në rritjen e afarizmit të KRU dhe cilësinë e shërbimeve të dhëna prej tyre është planifikuar të sigurohet përmes objektivave dhe aktiviteteve në vijim:

Objektiva 1: Zhvillimi i procesit të monitorimit dhe nxitjes së konkurrencës në sektorin e shërbimeve të ujit duke përdorur krahasime ("benchmarking") për të vlerësuar dhe stimuluar përmirësimin e performancës së ofruesve të shërbimeve të ujit

Aktivitetet:

- Ri-shqyrtimi i të dhënave dhe azhurnimi i formatit të raportimit tremujor për-2021;
- Organizimi dhe raportimi periodik dhe vjetor nga KRU;
- Inspektimi i procedurave dhe praktikave të mbajtjes së sistemit të menaxhimit të informacioneve-Zbatimi i udhëzuesit për raportimin dhe monitorimin e performancës së KRU, aktivitete para audituese;
- Auditimi i të dhënave të raportuara 2020;
- Përpilimi dhe publikimi i raportit vjetor të performancës për vitin 2020;
- Përpilimi i raporteve periodike të performancës (2021-H1 dhe 2021- H2).

Objektiva 2: Angazhimi në përmirësimin e indikatorëve të performancës së KRU

Aktivitetet:

- Përcaktimi i objektivave vjetore për TKP;
- Monitorimi dhe raportimi i progresit në përmbushjen e objektivave;
- Takim me 7 KRU-diskutimi individual i performancës vjetore;
- Monitorimi dhe vlerësimi i UPF;
- Implementimi dhe avancimi i Modulit të Bilancit të Ujit 2021;
- Analiza specifike në aspektet financiare dhe operative për shërbime të ujit.

Synimi Strategjik 4: Përmirësim i nivelit të përmbushjes së standardeve të shërbimeve

Përmes inspektimit, mbështetjes dhe monitorimit të ofruesve të shërbimit, ARRU në vazhdimësi i inkurajon, verifikon dhe i obligon ofruesit e shërbimeve për përmbushjen e standardeve të shërbimit të cilat janë obligative në bazë të legjislacionit dhe kushteve të licencës. Avancimi dhe përmirësimi i standardeve të shërbimit planifikohet të arrihet përmes mekanizmave të krijuara nga Autoriteti të cilët do të përmbushin objektivat dhe aktivitet në vijim:

Objektiva 1: Inspektimi i zbatimit të legjislacionit primar dhe sekondar të ARRU

Aktivitetet:

- Inspektimi i përmbushjes së nivelit të shërbimeve dhe kushteve të Licencës (Përditësimi i Modulit për inspektimin e standardeve dhe kushteve tjera të licencës)- për të gjithë ofruesit e shërbimeve;
- Përgatitja e Raportit të nivelit të shërbimeve të ofruara dhe përputhshmërisë me kushtet e Licencës nga ofruesit e licencuar;
- Inspektimi dhe përgaditja e raporteve me të gjetura dhe rekomandime për zbatimin e legjislacionit primar dhe sekondar të ARRU - për të gjithë ofruesit e shërbimeve;
- Inspektime dhe përgaditja e raporteve me të gjetura dhe rekomandime për inspektimet tematike/ at-hok sipas kërkesave të manaxhmentit (për të gjithë ofruesit e shërbimeve, apo për ofruesin e shërbimeve specifik – sipas kërkesës);
- Inspektimet dhe përgaditja e raporteve me të gjetura dhe rekomandime për inspektimet verifikuese (verifikimin e plotësimit të rekomandimeve nga inspektimet paraprake).

Objektiva 2: Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve dhe mjedisit në fushën e zbatimit të ligjit në raport me shërbime me konsumatorë

Aktivitetet:

- Ndihma për ofruesit e shërbimeve në hartimin e dokumentacionit që ka të bëjë me lehtësirat për shërbime të konsumatorëve;
- Monitorimi i punës së Komisioni për Zgjidhjen e Ankesave të shkallës së parë të ofruesve të shërbimeve, lidhur me pranimin, zgjidhjen dhe vendimmarrjen për ankesa të konsumatorëve;
- Analiza në aspektin e punës së ofruesve të shërbimeve të ujit lidhur me çështjet e ankesave të konsumatorëve, si dhe përgatitja e rekomandimeve për përmirësim të gjendjes.

Objektiva 3: Monitorimi i kushteve të licencës lidhur me integrimin dhe zgjerimin e zonës së shërbimit me qëllim të zbatimit të legjislacionit për ndryshim të licencave të KRU

Aktivitetet:

- Integrimi i njësive operative të shërbimeve të ujit të Hanit të Elezit dhe Shtërpcës në kuadër të KRU "Bifurkacioni", të cilat janë duke ofruar shërbime jashtë licencës së shërbimit;
- Angazhim me KRU "Hidromorava" lidhur me zgjerimin e zonës së shërbimit në Komunën e Ranillugut, Parteshit dhe Novobërdës;
- Monitorimi i furnizimit me ujë të Mamushës, sipas licencës të KRU "Hidroregjioni Jugor";
- Analizimi dhe shqyrtimi i aplikacioneve të KRU-ve lidhur me plotësimin e kritereve për integrimin në Licencë të shërbimit;
- Monitorimi në vazhdimësi i ofruesve të shërbimeve lidhur me përmbushjen e kushteve të licencës nga ana e tyre.

Objektiva 4: Mbrojtja e të drejtave të konsumatorëve dhe zbatimi i ligjshmërisë dhe vendimmarrjes për shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve të ujit

Aktivitetet:

- Takimet e rregullta të KZA, lidhur me shqyrtimin dhe vendimmarrjen për ankesat e konsumatorëve;
- Takime me KRU lidhur me problemet të cilat paraqiten në procedurat për ankesat dhe paditë të parashtruara nga konsumatorët;
- Inspektimet në KRU në lidhje me zbatimin e vendimeve të KZA që kanë të bëjnë me shërbimet ndaj konsumatorëve;
- Bashkëpunimi me MTI-Departamentin për mbrojtjen e konsumatorëve dhe palët e tjera të interesit për mbrojtjen e të drejtave të Konsumatorëve.

Synimi Strategjik 5: Qëndrueshmëria operative dhe financiare e ARRU

Për të përmbushur detyrat dhe obligimet e ARRU është e domosdoshme që institucioni të ketë qëndrueshmëri operative dhe financiare. Avancimi në aspektin e trajnimit të stafit, përdorimit të teknologjisë më të avancuar, pjesëmarrja në forume dhe konferenca ndërkombëtare janë faktorë të cilët ndikojnë në përmbushjen e synimeve strategjike të ARRU. Për të përmbushur këto qëllime janë paraparë objektivat dhe aktivitetet në vijim:

Objektiva 1: Zhvillimi dhe avancimi profesional i stafit

Aktivitetet:

- Angazhim rreth gjetjes së mundësive për rritjen e numrit të stafit;
- Trajnime të stafit;
- Planifikimi i udhëtimeve jashtë vendit;
- Pjesëmarrja në forume dhe konferenca vendore dhe ndërkombëtare.

Objektiva 2: Planifikimi dhe administrimi operativ dhe financiar

Aktivitetet:

- Mbyllja e vitit fiskal 2020 dhe hapja e vitit fiskal 2021;
- Planifikimi i zotimeve dhe shpenzimeve;
- Monitorimi dhe menaxhimi i buxhetit;
- Raportimin financiar;
- Prokurorimet;

- Rexhistrimin dhe mirëmbajtjen e Aseteve të ARRU-së;
- Monitorimi dhe përkrahja personelit të ARRU-së në çështjet administrative;
- Menaxhimi i DB së të Dhënave;
- Mirëmbajtja e DB së Pagesave;
- Mirëmbajtja dhe sigurimi i objektit.

Objektiva 3: Hartimi dhe menagjimi i dokumenteve të punës

Aktivitetet:

- Raportet vjetore të punës për vitin 2020;
- Raportet periodike (javore, mujore);
- Plani strategjik i ARRU-së (2021-2023);
- Plani i punës për vitin 2022;
- Arkivimi i dokumentacionit dhe administrimi i lëndeve të Punës, etj.

Synimi Strategjik 6: Ngritja e profilit të ARRU

Komunikimi i hapur me të gjitha palët e interesit për aktivitetet e ARRU ndikon në krijimin e besimit të publikut dhe njëkohësisht ngrit profilin e ARRU. Bashkëpunimi me institucionet vendore mundëson koordinim më të mirë rreth përmirësimit të nivelit të shërbimeve, ndërsa bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare përveç që ndikon në adaptimin e praktikave më të mira, do të ndikojë edhe në ngritjen e profilit të ARRU dhe vet shtetit në nivel ndërkombëtar. Për arritjen e këtij synimi janë planifikuar objektivat dhe aktivitetet si në vijim:

Objektiva 1: Avancimi i marëdhënieve me publikun

Aktivitetet:

- Informimi dhe komunikimi efektiv me ofruesit e shërbimeve, konsumatorët dhe politikë bërsit;
- Informimi dhe sensibilizimi i konsumatorëve për të drejtat e tyre;
- Azhurnimi dhe përditësimi i ueb faqes zyrtare të ARRU;
- Organizimi i konferencave për shtyp për ngjarjet me rëndësi, nga/për proceset rregullatore;
- Pjesëmarrja në konferenca, punëtori dhe takime për çështjet e shërbimeve të ujit;
- Përgaditja, botimi dhe shpërndarja e fletushkave.

Objektiva 2: Bashkëpunimi me institucionet vendore dhe ndërkombëtare

Aktivitetet:

- Bashkëpunimi me KNMU, në hartimin dhe implementimin e dokumenteve strategjike të KRU dhe çështjeve tjera;
- Bashkëpunimi me IKSHPK-amandamentimi dhe Implementimi i UA, 16/2012 dhe monitorimi i kualitetit të ujit;
- Bashkëpunim me ZPS e Qeverisë së Kosovës-SKZH-2030;
- Bashkëpunimi me institucionet Qeveritare (MZHE, MMPH, MIE, ZPS , ASK, etj) për raportimin e rregullt dhe shpërndarjes së informacioneve për/nga KRU;
- Vazhdimi i bashkëpunimi me WAREG, IAWD- IBNET, DANUBIS, ERRU dhe me institucionet e tjera të rëndesishme ndërkombëtare.

6. PLANI DINAMIK PËR VITIN 2021

Synimi Strategjik 1: Avancimi dhe zbatimi i legjislacionit													
Objektiva 1: Krijimi i mjedisit të favorshëm ligjor rregullator për përmirësimin e vazhdueshëm në fushën e rregullimit të veprimtarisë të ofrueseve të shërbimeve të ujit													
Aktivitetet	Dep. Pergjëgjës	Periudha kohore Janar-Dhjetor 2021											
		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
Ndryshim plotësimi i Ligjit për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, në rast të iniciativës nga Kuvendi apo Qeveria	DÇL&L, ARRU												
Përafrimin e legjislacionit të ARRU me legjislacionin e Bashkimit Evropian,	DÇL&L, ARRU												
Mbështetje profesionale në hartimin e akteve normative të KRU-ve dhe vlerësimin e ligjshmërisë së tyre	DÇL&L, ARRU												
Hartimi i shkresave zyrtare, vendimet për ankesat të shqyrtuara dhe shkresa tjera	DÇL&L, ARRU												
Hartimi i vendimeve, kontratave, marrëveshjeve dhe dokumenteve ligjore që ndikojnë në zbatimin e mandatit ligjor të ARRU-së	DÇL&L, ARRU												
Përcjellja e proceseve gjyqësore, përgatitja e parashtresave të lëndëve për procedim në Gjykata dhe pjesëmarrja në seancat gjyqësore sipas kërkesës së Gjykatave të Republikës së Kosovës lidhur me të gjitha lëndët që kanë të bëjnë me ARRU-në	DÇL&L, ARRU												
Rishikimi i infrastrukturës ligjore lidhur me nevojat për ndryshim plotësim të akteve nënligjore të ARRU	DÇL&L, ARRU												
Përgjigje në ankesat e pranuara nga personat fizik dhe juridik, për çështje të ndryshme lidhur me shërbimet e ofruara	DÇL&L, ARRU												

Synimi Strategjik 2: Avancimi dhe zbatimi efektiv i procesit tarifor

Objektiva 1: Shqyrtimi i procesit tarifor aktual

Aktivitetet	Dep. Pergjëgjës	Periudha kohore Janar-Dhjetor 2021											
		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
Përfundimi i raportit mbi vlerësimin e shkallës së përmbushjes së objektivave të KRU-ve gjatë vitit 2020	DT												
Analiza e Realizimit të Caqeve për vitin 2020	DT												
Analiza Vjetore e Investimeve Kapitale për vitin fiskal 2020	DT												
Vizita të rregullta dhe të jashtëzakonshme të KRU-ve për mbledhjen dhe inspektim të të dhënave për vlerësim të punës së tyre gjatë vitit 2021	DT												
Analiza e shpenzimeve të sektorit për vitin 2020	DT												

Objektiva 2: Procesi tarifor 2022 - 2024

Aktivitetet përgaditore për procesin tarifor 2022-2024	DT												
Mbajtja e takimeve me përfaqësuesit e KRU-ve, për të definuar çështjet tarifore për vitin 2022 si dhe draftimi dhe diskutimi i BPRR	DT												
Organizimi i dëgjimeve publike	DT												
Përgatitjet dhe lëshimi Urdhëresave tarifore për tarifat e shërbimeve të ujit 2022-2024 për të gjitha KRU`të	DT, ARRU												

Objektiva 3: Avancimi i politikave tarifore													
Rishqyrtimi i Politikave Tarifore dhe Udhëzimit të Kontabilitetit Tarifor	DT												
Analiza periodike për përsosjen e sistemit tarifor	DT												
Angazhimi për të siguruar donacion për ekspertizë ndërkombëtare të politikave tarifore dhe implementimin e tyre konform rrethanave të ARRU	DT, ARRU												
Objektiva 4: Azhurnimi dhe publikim i dokumenteve për procesin tarifor													
Përgatitjet dhe lëshimi Urdhëresave tarifore për tarifat e shërbimeve të ujit 2022 për të gjitha KRU'të	DT;ARRU												
Angazhim rreth implementimit të PMA në KRU, 2021	DT												
Mbledhja, regjistrimi, analiza dhe vlerësimi i të dhënave të realizuar nga KRU-të për përcaktim të tarifave të vitit 2022	DT												
Përditësimi i Hartave në GIS	DT, ARRU												

Synimi Strategjik 3: Përmirësimi i performancës së ofruesve të shërbimeve

Objektiva 1: Zhvillimi i procesit të monitorimit dhe nxitjes së konkurrencës në sektorin e shërbimeve të ujit duke përdorur krahasime ("benchmarking") për të vlerësuar dhe stimuluar përmirësimin e performancës së ofruesve të shërbimeve të ujit.

Aktivitetet	Dep. Pergjëgjës	Periudha kohore Janar-Dhjetor 2021											
		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
Ri-shqyrtimi i të dhënave dhe azhurnimi i formatit të raportimit tremujor për-2021	DRP, ARRU												
Organizimi dhe raportimi periodik dhe vjetor nga KRU	DRP, ARRU												
Inspektimi i procedurave dhe praktikave të mbajtjes se sistemit të menaxhimit të informacione-Zbatimi i udhëzuesit për raportimin dhe monitorimin e performancës, së KRU, aktivitete para audituese	DRP, ARRU												
Auditimi i të dhënave 2020	DRP, DT												
Përpilimi i dhe publikimi i raportit vjetor të performancës për vitin 2020	DRP, ARRU												
Përpilimi i raporteve periodike të performancës (2021-H1 dhe 2021- H2)	DRP												
Objektiva 2: Angazhim në përmirësimin e indikatorëve të performancës së KRU													
Përcaktimi i objektivave vjetore për TKP	DRP												
Monitorimi dhe raportimi i progresit në përmbushjen e objektivave	DRP												
Takim me 7 KRU-diskutimi individual i performances vjetore	DRP, ARRU												
Monitorimi dhe vlerësimi i UPF	DRP												
Implementimi dhe avancimi i Modulit të Bilancit të Ujit 2021	DRP												
Analiza specifike në aspektet financiare dhe operative për shërbime të ujit	DRP												

Synimi Strategjik 4: Përmirësim i nivelit të përmbushjes së standardeve të shërbimeve

Objektiva 1: Inspektimi i zbatimit të legjislacionit primar dhe sekondar të ARRU

Aktivitetet	Dep. Pergjëgjës	Periudha kohore Janar-Dhjetor 2021											
		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
Inspektimi i përmbushjes së nivelit të shërbimeve dhe kushteve te Licencës (Përditësimi i Modulit për inspektimin e standardeve dhe kushteve tjera të licencës)- për të gjithë ofruesit e shërbimeve	Nj.I, ARRU												
Përgatitja e Raportit të nivelit të shërbimeve të ofruara dhe përputhshmërisë me kushtet e Licencës nga ofruesit e licencuar	Nj.I												
Inspektimi dhe përgaditja e raporteve me të gjetura dhe rekomandime për zbatimin e legjislacionit primar dhe sekondar të ARRU - për të gjithë ofruesit e shërbimeve	Nj.I, ARRU												
Inspektime dhe përgaditja e raporteve me të gjetura dhe rekomandime për inspektimet tematike/ at-hok sipas kërkesave të manaxhmentit (për të gjithë ofruesit e shërbimeve, apo për ofruesin e shërbimeve specifik – sipas kërkesës	Nj.I, ARRU												
Inspektimet dhe përgaditja e raporteve me të gjetura dhe rekomandime për inspektimet verifikuese (verifikimin e plotësimit të rekomandimeve nga inspektimet paraprake	Nj.I												

Objektiva 2: Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve dhe mjedisit në fushën e zbatimit të ligjit në raport me shërbime me konsumatorë													
Ndihma për ofruesit e shërbimeve në hartimin e dokumentacionit që ka të bëjë me lehtësirat për shërbime të konsumatorëve	DÇL&L												
Monitorimi i punës së Komisioni për Zgjidhjen e Ankesave të shkallës së parë të ofruesve të shërbimeve, lidhur me pranimin, zgjidhjen dhe vendimmarrjen për ankesa të konsumatorëve	DÇL&L												
Inspektimi i punës së Komisionit për zgjidhjen e ankesave të shkallës së parë të ofruesve të shërbimeve, lidhur me pranimin, zgjidhjen dhe vendimmarrjen për ankesa të konsumatorëve.	DÇL&L												
Analiza në aspektin e punës së ofruesve të shërbimeve të ujit lidhur me çështjet e ankesave të konsumatorëve si dhe përgatitja rekomandime për përmirësim të gjendjes	DÇL&L												
Ndihma nga DÇL&L për ofruesit e shërbimeve në hartimin e dokumentacionit që ka të bëjë me lehtësirat për shërbime të konsumatorëve	DÇL&L												
Objektiva 3: Monitorimi i kushteve të licencës lidhur me integrimin dhe zgjerimin e zonës së shërbimit me qëllim të zbatimit të legjislacionit për ndryshim të licencave te KRU-ve													
Integrimi i njësive operative të shërbimeve të ujit të Hanit të Elezit dhe Shtërpcës në kuadër të KRU "Bifurkacioni", të cilat janë duke ofruar shërbime jashtë licencës së shërbimit	DÇL&L												
Angazhim me KRU "Hidromorava" lidhur me zgjerimin e zonës së shërbimit në Komunën e Ranillugut, Parteshit dhe Novobërdës	DÇL&L												
Monitorimi i furnizimit me uji të Mamushës, sipas licencës të KRU "Hidroregjioni Jugor"	DÇL&L												
Analizimi dhe shqyrtimi i aplikacioneve të KRU-ve lidhur me plotësimin e kritereve për integrimin në Licencë të shërbimit	DÇL&L												
Monitorimi në vazhdimësi i ofruesve të shërbimeve lidhur me përmbushjen e kushteve të licencës nga ana e tyre	DÇL&L												

Objektiva 4: Mbrojtja e të drejtave të konsumatorëve dhe zbatimi i ligjshmërisë dhe vendimmarrjes për shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve të ujit.													
Takimet e rregullta të KZA lidhur me shqyrtimin dhe vendimmarrjen për ankesat e konsumatorëve	DÇL&L												
Takime me KRU lidhur me problemet të cilat paraqiten në procedurat për ankesat dhe paditë e parashtruara nga konsumatorët	DÇL&L												
Shqyrtimi dhe zgjidhja e ankesave tw konsumatorëve	DÇL&L												
Inspektimet në KRU në lidhje me zbatimin e vendimeve të ARRU që kanë të bëjnë me shërbimet ndaj konsumatorëve	DÇL&L												
Bashkëpunimi me MTI-Departamentin per mbrojtjen e konsumatorve dhe palët e tjera interesit per mbrojtjen e te drejtave te Konsumatorëve	DÇL&L												

Synimi Strategjik 5: Qëndrueshmëria operative dhe financiare e ARRU													
Objektiva 1: Zhvillimi dhe avancimi profesional i stafit													
Aktivitetet	Dep. Pergjëgjës	Periudha kohore Janar-Dhjetor 2021											
		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
Angazhim rreth gjetjes së mundësive për rritjen e numrit të stafit	ARRU												
Trajnime të stafit	ARRU												
Planifikimi i udhëtimeve jashtë vendit	DAF, ARRU												
Pjesëmarrja në forume dhe konferenca vendore dhe ndërkombëtare	DAF, ARRU												
Objektiva 2: Planifikimi dhe administrimi operativ dhe financiar.													
Mbyllja e vitit fiskal 2020 dhe hapja e vitit fiskal 2021	DAF												
Planifikimi i zotimeve dhe shpenzimeve	DAF												
Monitorimi dhe menaxhimi i buxhetit	DAF												
Raportimin financiar	DAF, ARRU												
Prokurorimet	DAF												
Rexhistrimin dhe mirëmbajtjen e Aseteve të ARRU-së	DAF												
Monitorimi dhe përkrahja personelit të ARRU-s ë në të gjitha çështjet administrative	DAF												
Menaxhimi i DB së të Dhënave	DAF												
Mirëmbajtja e DB së Pagesave	DAF												
Mirëmbajtja dhe sigurimi i objektit	DAF												

Objektiva 3: Hartimi dhe menagjimi i dokumenteve të punës													
Raportet vjetore të punës për vitin 2020	ARRU												
Raportet periodike (javore, mujore)	ARRU												
Plani i punës për vitin 2022	ARRU												
Arkivimi i dokumentacionit dhe administrimi i lëndeve të Punës.	ARRU												

Synimi Strategjik 6: Ngritja e profilit të ARRU-së

Objektiva 1: Avancimi i Marëdhënieve me publikun

Aktivitetet	Dep. Pergjëgjës	Periudha kohore Janar-Dhjetor 2021											
		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
Informimi dhe komunikimi efektiv me ofruesit e shërbimeve, konsumatorët dhe politikë bërsit	ZMP, ARRU												
Informimi dhe sensibilizimi i konsumatorëve për të drejtat e tyre	ZMP, ARRU												
Azhurnimi dhe përditësimi i ueb faqes zyrtare të ARRU	ZTI, ARRU												
Organizimi i konferencave për shtyp për ngjarjet me rëndësi	ZMP, ARRU												
Pjesëmarrja në konferenca, punëtori dhe takime për çështjet e shërbimeve të ujit	ARRU												
Përgaditja, botimi dhe shpërndarja e fletushkave	ARRU												

Objektiva 2: Bashkëpunimi me institucionet vendore dhe ndërkombëtare

Bashkëpunimi me KNMU, në hartimin dhe implementimin e dokumenteve strategjike të KRU dhe çështjeve tjera	ARRU												
Bashkëpunimi me IKSHPK- amandamentimi dhe Implementimi i UA, 16/2012 dhe monitorimi i kualitetit të ujit dhe çështjeve tjera	ARRU												
Bashkëpunim me ZPS se Qeverisë së Kosovës-SKZH-2030	ARRU												
Bashkëpunimi me institucionet Qeveritare (MZHE, MMPH, MIE, ZPS , ASK, etj) për raportimin e rregullt dhe shpërndarjes se informacioneve	ARRU												
Vazhdimi i bashkëpunimi me WAREG, IAWD- IBNET, DANUBIS, me institucionet e tjera të rëndesishme ndërkombëtare	ARRU												
Bashkëpunim, takime dhe shkëmbim i përvojave meRregullatorët me të cilët ARRU ka Memorandum të Bashkëpunimit	ARRU												

7. REALIZIMI DHE MONITORIMI I PLANIT

Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të planit në aspektin dinamik/kohor dhe cilësor do të bëhet në baza javore dhe mujore përmes raportimeve nga kryesuesit e departamenteve dhe njësive të ARRU. Përgjegjës për monitorimin e zbatimit të përgjithshëm të synimeve dhe objektivave janë Drejtori dhe Zëvendës Drejtori, ndërsa përgjegjës për monitorimin e zbatimit të aktiviteteve të planit të cilat korrospodojnë me përgjegjësitë përkatëse të departamenteve dhe njësisë, janë kryesuesit e dapartamenteve dhe njësisë.

Vlerësimi i nivelit të realizimi të objektivave të planifikuara do të bëhet në fund të vitit 2021, me rastin e raportimit vjetor përmes:

- Aspektit sasior, në kuptim të vëllimit të veprimeve të punëve të kryera në raport me objektivat e planifikuara;
- Aspektin cilësor, në kuptim të cilësisë së punës në raport me objektivat e përcaktuara;
- Aspektin kohor në kuptim të përmbushjes së afateve kohore në raport me dinamikën e planifikuar për realizimin e objektivave të parapara.

Në bazë të këtij vlerësimi, në fund të vitit 2021 do të bëhet edhe vlerësimi i të të punësuarve të ARRU.

8. FINANCIMI I PLANIT-BUXHETI PËR VITIN 2021

Financimi për realizimin e këtij plani është planifikuar nga të hyrat (buxheti) e rregullta të ARRU.

Në bazë të Ligjit Nr. 05/L-042, ARRU financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës, në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike.

Buxheti vjetor i ARRU aprovohet çdo vit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Lartësia e taksave të licencimit caktohet në bazë vjetore sipas kritereve vijuese:

- Të hyrat nga këto taksa duhet të korrespondojnë me shpenzimet e planifikuara të ARRU për vitin respektiv, si dhe
- Lartësia e taksës nuk duhet të tejkalojë 1.5% të faturimi bruto vjetor të ofruesve të shërbimeve.

Buxheti për vitin 2021

Paga dhe Mëditje	249,330.00 €
Mallra dhe Shërbime	112,572.00€
Shërbime Komunale	6,503.00 €
Total	368,405.00 €

Në mungesë të mjeteve vetanake, për disa nga aktivitetet e caktuara të këtij plani do të kërkohet mundësia e financimit nga donatorët dhe buxheti i Kosovës.

9. LISTA DHE MENAXHIMI I RISKUT

Duke u bazuar në vëllimin e aktiviteteve, kapacitetetve njerëzore, kapaciteteve profesionale dhe materiale është paraparë lista dhe menaxhimi i riskut.

- Mos ekzekutimi i planifikuar i buxhetit;
- Mos grumbullimi i të hyrave nga TVL;
- Mos realizimi i prokurimeve të planifikuara;
- Ngecje në ekzekutimin e pagesave në kohë dhe pa gabime;
- Mospërputhje kohore e raportimeve nga KRU me kërkesat për analiza të brendshme rregullatore, si dhe përmbushjen e obligimeve raportuese ndaj palëve tjera;
- Mungesa e mbështetjes me konsulentë;
- Ngarkesa shtesë e gjithë personelit të departamenteve funksionale në punë dytësore administrative të Autoritetit;
- Kufizimet buxhetore dhe kufizimet në aftësi komunikuese (gjuha angleze) të një pjesë të stafit për pjesëmarrje në trajnime specifike, konferenca, vizita studimore, etj;
- Mungesa e një pjese të stafit e ndikuar nga aspektet shëndetësore dhe familjare;
- Vazhdimi i kufizimeve të caktuara për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia COVID-19.

Menaxhimi i riskut do të bëhet duke ndërmarrë angazhimet si në vijim:

- Ekzekutimi i buxhetit mvaret nga realizimi i prokurimeve të planifikuara, prandaj do të bëhen përpjekje intensive me AQP që prokurimet e planifikuara të realizohen me dinamikën e paraparë;
- Duke u bazuar në vitet paraprake, të hyrat nga TVL me përjashtim të KRU Mitrovica janë të realizueshme 100%, prandaj do të intensifikohen kërkesat për pagesë të TVL nga ana e KRU Mitrovica;
- Do të behet mobilizim i gjithë stafit të administratës dhe tjerëve për të plotësuar vakumet e personelit, në mënyrë që të gjitha punët administrative të autoritetit të realizohen me kohë;
- Do të shiqohet mundësia e alokimit të punëve jashtë orarit, për të realizuar vëllimin e punëve të planifikuara;
- Kerkesa tek donatoret për mbështetje institucionale;

Angazhimi për shtimin e kapaciteteve humane (punësimi shtesë).

Nëntor, 2020

Raif Preteni, Drejtor i ARRU